



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 62

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9102 datë 10.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".....	2081
Vendim i Kuvendit nr.81, datë 15.7.2003	Për miratimin e raportit përfundimtar, konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komisionit Hetimor Parlamentar të ngritur me vendimin nr.72, datë 17.3.2003.....	2785
Vendim i KM nr.493, datë 18.7.2003	Për shtyrjen e afatit të negociatave për fazën e parë të privatizimit të INSIG-sh.a.....	2785
Vendim i KM nr.494, datë 18.7.2003	Për miratimin e çmimit të negociuar për shitjen e aksioneve të INSIG-sh.a. (faza e parë).....	2786
Vendim i KM nr.495, datë 18.7.2003	Për përcaktimin e kushteve të personave dhe sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit...	2786
Vendim i KM nr.498, datë 18.7.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë".....	2787

Vendim i KM nr.499, datë 18.7.2003	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit.....	2788
Vendim i KM nr.500, datë 18.7.2003	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit.....	2789
Vendim i KM nr.501, datë 18.7.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.230, datë 22.5.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe organikën analitike të administratës doganore”, i ndryshuar.....	2791
Vendim i KM nr.503, datë 18.7.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Valias-Qerrekë-Rinas, si dhe të pronarëve, pasuritë e të cilëve ndodhen brenda rrethimit të aeroportit “Nënë Tereza”.....	2791
Vendim i KM nr.506, datë 18.7.2003	Për ndërtimin me koncesion të Autostradës Rrogozhinë-Pezë-Degëzim Tiranë-Vorë-Thumanë dhe caktimin e organit shtetëror të autorizuar.....	2793
Vendim i KM nr.507, datë 18.7.2003	Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit.....	2794
Vendim i KM nr.508, datë 18.7.2003	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë	2795
Vendim i KM nr.516, datë 18.7.2003	Për kalimin e varësisë së Tipografisë Ushtarake-sh.a. nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.....	2798
Udhëzim i KM nr.4, datë 18.7.2003	Për kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik, që duhet të përmbajë dosja e digave dhe e dambave.....	2798

L I G J
Nr.9102, datë 10.7.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8737, DATË 12.2.2001 "PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja "a", 83 pika 1, 148 dhe 149 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 pika 3, pas fjalisë së fundit shtohet fjalia: "Shkalla e hierarkisë në organin e Prokurorisë përcaktohet nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj".

Neni 2

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli i nenit bëhet: "Kompetencat".

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Prokurori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në emër të shtetit, si dhe për realizimin e detyrave të tjera që, me ligj, i ngarkohen Prokurorisë."

c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Prokurori i Përgjithshëm, në mungesë të tij, mund t'ia delegojë përgjegjësitë njërit prej drejtorëve të zyrës së vet, me përjashtim të atyre që parashikohen në shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "g" të pikës 2 të këtij neni."

Neni 3

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Struktura

1. Struktura e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm përbëhet nga:

a) kabineti;

b) drejtoritë;

c) sektorët.

2. Struktura, organizimi dhe përcaktimi i hollësishëm i funksioneve të hallkave të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm bëhen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm funksionojnë shërbimet e ekspertimeve, organizimi dhe funksionimi i të cilave përcaktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm."

Neni 4

Pika 1 e nenit 10 ndryshohet si më poshtë:

"1. Këshilli i Prokurorisë organizon konkursin e kandidatëve për prokurorë dhe të atyre që do të ngrihen në detyrë, shqyrton vlerësimin e punës, si dhe jep mendim për shkelje disiplinore të kryera nga prokurorët, për të cilat Prokurori i Përgjithshëm i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin nga detyra të prokurorëve".

Neni 5

Në pikën 1 të nenit 13 fjalët "Prokurorisë së Përgjithshme" zëvendësohen me fjalët "zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm".

Neni 6

Neni 19 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Prokurori i Përgjithshëm shpall publikisht vendet vakant për prokurorë, së paku një muaj para datës së caktuar për zhvillimin e konkurrimit. Shpallja bëhet të paktën në dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të mjaftueshëm, si dhe në Radio Televizionin Publik.".

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Depozitimi i kërkesave, të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim, duhet të bëhet nga konkurruesit jo më vonë se dy javë nga data e shpalljes publike të vendit vakant.".

Neni 8

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21
Emërimi

Kandidatët për prokurorë emërohen në detyrë nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e Këshillit të Prokurorisë.".

Neni 9

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24
Ngritja në detyrë dhe transferimi

1. Transferimi i prokurorit mund të bëhet për nevoja të organizimit dhe të funksionimit normal të hallkave të ndryshme të sistemit të prokurorisë, si dhe në rastet kur kërkohet nga prokurori.

2. Transferimi dhe ngritja në detyrë e prokurorit në një nivel më të lartë prokurorie bëhen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm.".

Neni 10

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Prokurori i Përgjithshëm mund të komandojë prokurorë nga prokuroritë ku punojnë në prokurori të tjera:

a) jo më shumë se katër muaj në vit, në rastet kur një prokurori nuk funksionon normalisht, për shkak të pamjaftueshmërisë së numrit të prokurorëve dhe të mbingarkesës së tyre;

b) jo më shumë se kohëzgjatja e përfundimit të një procedimi penal të veçantë, kur paraqitet nevoja e kryerjes së hetimeve paraprake apo e gjyqimit të tij."

Neni 11

Në nenin 27:

- Shkronja "b" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"b) kur mbush moshën e pensionit;"

- Shkronja "b" e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

"b) kur ndaj tij merret masa disiplinore, sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 33."

Neni 12

Në pikën 1 të nenit 28 fjalët "kryesisht ose me rekomandim të Këshillit të Prokurorisë" shfuqizohen.

Neni 13

Në nenin 33 shkronja "c" e pikës 1 riformulohet si më poshtë:

"c) kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë."

Neni 14

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 34

Ankimi

1. Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 33 të ligjit, prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa prokurorët pranë kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit më të afërt."

2. Në rastet e shkarkimit nga detyra, prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa prokurorët pranë këtij niveli gjykate në gjykatën e apelit më të afërt. Kur gjykata çmon se shkarkimi nga detyra është i pabazuar në ligj, prokurori përfiton pagën deri në një vit pune, e cila paguhet nga Prokuroria."

Neni 15

Në nenin 35, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Prokurorëve, që e ushtrojnë detyrën pranë gjykatave të krimeve të rënda, u sigurohet i njëjti trajtim dhe e njëjta mbrojtje si gjyqtarëve të këtyre gjykatave."

Neni 16

Pika 1 e nenit 49 ndryshohet si më poshtë:

"1. Koha javore e punës dhe orarit, si rregull, janë të njëjta me ato të gjykatave."

Neni 17

Në nenin 52 pika 5 fjalët "10 për qind" ndryshohen në "20 për qind".

Neni 18

Në nenin 54 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Nga të ardhurat që kanë kaluar në favor të shtetit, si rezultat i sekuestrimit të provave materiale në përfundim të një procedimi penal, Këshilli i Ministrave përcakton pjesën që i kalon Prokurorisë për t'u përdorur për mjete logjistike dhe për shpërblimin e prokurorëve.".

Neni 19

Në nenin 57 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Pranë prokurorive të shkallës së parë, Prokurori i Përgjithshëm mund të emërojë kancelarë për ndjekjen e problemeve të karakterit administrativ e financiar. Paga e tyre është e njëjtë me atë të kancelarëve pranë gjykatave.".

Neni 20

Neni 58 riformulohet si më poshtë:

"Neni 58

Punonjësit e administratës së zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, për pranimin, transferimin, lëvizjen paralele, ngritjen ose shkarkimin në detyrë u nënshtrohen kritereve dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.".

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3905, datë 25.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

V E N D I M **Nr.81, datë 15.7.2003**

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR, KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR TË NGRITUR ME VENDIMIN NR.72, DATË 17.3.2003

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet raporti përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor të Kuvendit, të ngritur me vendimin nr.72, datë 17.3.2003 "Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raportit përfundimtar i bashkëlidhet mendimi i pakicës, sipas nenit 21 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.493, datë 18.7.2003

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË NEGOCIATAVE PËR FAZËN E PARË TË PRIVATIZIMIT
TË INSIG -SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG-sh.a.”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Shtyrjen e afatit të negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare për fazën e parë të privatizimit të INSIG-sh.a., për një periudhë kohore 6-mujore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.494, datë 18.7.2003

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË NEGOCIUAR PËR SHITJEN E AKSIONEVE TË INSIG-
SHA, (FAZA E PARË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 3 të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG-sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e çmimit të negociuar për vlerën totale (100%) të aksioneve të INSIG-sh.a., prej 3 200 000 000 (tre miliardë e dyqind milionë) lekësh.

2. Vlera që IFC-ja dhe BERZH-i do të paguajnë për blerjen e aksioneve të INSIG-sh.a. të jetë 39 për qind e vlerës së parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.495, datë 18.7.2003

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË PERSONAVE DHE SASISË SË NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të nenit 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen në portet e peshkimit të Shëngjinit, të Durrësit, të Vlorës dhe të Sarandës, brenda zonës doganore, të stacioneve të shitjes së gazoilit (dizel) për anijet e peshkimit të licencuara për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2. Tregtimi i karburanteve për furnizimin e anijeve të peshkimit të bëhet vetëm nga persona juridikë, të pajisur me lejet përkatëse, në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

3. Përcaktimi i shoqërisë furnizuese të bëhet në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

4. Gazoili t’u shitet Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), sipas porteve të peshkimit, të cilat duhet:

a) të paraqesin kërkesën dhe grafikun e nevojave të anijeve të peshkimit për furnizimin me naftë;

b) të organizojnë grumbullimin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar në udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Takim-Taksave, dalë në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar.

5. Rimbursimi i akcizës t’i bëhet drejtpërdrejt shoqërisë furnizuese një herë në tre muaj, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga OMP-të e peshkimit.

6. Në bazë të numrit të anijeve të peshkimit dhe të fuqisë motorike të tyre, sasia e gazoilit për 1 vit nuk duhet t’i kalojë sasisë e mëposhtme:

- a) Durrës 10 000 tonë;
- b) Vlorë 9 000 tonë;
- c) Shëngjin 6 000 tonë;
- ç) Sarandë 3 000 tonë.

7. Për periudhën 1 korrik 2003 deri në 31 dhjetor 2003 sasia e gazoilit për nevojat e peshkimit të jetë, për portet e përmendura në pikën 6 të këtij vendimi, sa gjysma e sasisë vjetore.

8. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet kapitenerive të porteve, Ministria e Rendit Publik, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (Drejtorisë së Policisë Kufitare), si dhe Ministria e Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe asaj të Tatim-Taksave, të ndjekin procedurat e nisjes dhe të mbërritjes së anijeve të peshkimit për dhe nga zonat e peshkimit.

9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave të nxjerrin udhëzimet për regjistrin e karburanteve të anijeve të peshkimit dhe regjistrin e furnizimit të stacioneve të shitjes së karburanteve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.498, datë 18.7.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.343, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË

**MINISTRAVE “PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE
JURIDIKË, PUBLIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**V E N D I M
Nr.499, datë 18.7.2003**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE TË KALIBRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 2 e 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “specialist”, “përgjegjës sektori”, “drejtor drejtorie” dhe “drejtor i përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “inspektor”, “kryetar degë” dhe “drejtor i drejtorisë rajonale” në drejtorinë rajonale, degët dhe zyrat e metrologjisë dhe të kalibrimit të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve nr.1 dhe nr.2 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

4. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

5. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

6. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjeve nr.1 dhe nr.2.

7. Punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit të paguhet sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

8. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

9. Efekti financiar për vitin 2003, të përballohet nga të ardhurat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE TË KALIBRIMIT**

Klasa	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		Shtesa e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
		1	2	3	4
II-a	Drejtor i Përgjithshëm	9 000	2%	0	90 000
II-b	Drejtor Drejtorie	9 000	2%	0	74 000
III-b	Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	40 000
IV-b	Specialist	9 000	2%	0	20 000

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORIVE
RAJONALE, DEGËVE DHE ZYRAVE TË METROLOGJISË**

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
	1	2	3	4
Drejtor i drejtorisë rajonale	9 000	2%	0	40 000
Kryetar dege	9 000	2%	0	20 000
Inspektor	9 000	2%	0	16 000

V E N D I M
Nr.500, datë 18.7.2003

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në zyrën e Avokatit të Popullit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Nivelet e pagave, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, për emërtesat e mëposhtme të jenë:

- “shef kabineti i Avokatit të Popullit” barazohet në pagë me “këshilltarin e Kryeministrit”;

- “këshilltari i Avokatit të Popullit” barazohet në pagë me “ndihmësin e Kryeministrit”;

- “sekretari i Avokatit të Popullit” barazohet në pagë me “sekretarin e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit”;

- “sekretari në zyrën e Avokatit të Popullit” barazohet në pagë me “sekretar ministri”.

7. Për punonjësit e tjerë të zyrës së Avokatit të Popullit të zbatohet lidhja II/4 “Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

8. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja nr.1

Klasa	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
I-a	Sekretar i Përgjithshëm	9 000	2%	0	111 000
II-a	Ndihmëskomisioner kategoria e parë	9 000	2%	0	90 000
II-b	Ndihmëskomisioner kategoria e dytë Drejtor Drejtorie	9 000	2%	0	74 000
III-a	Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	55 000

IV-b	Specialist	9 000	2%	0	20 000
------	------------	-------	----	---	--------

V E N D I M
Nr.501, datë 18.7.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.230, DATË 22.5.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE ORGANIKËN ANALITIKE TË
ADMINISTRATËS DOGANORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.230, datë 22.5.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në Departamentin Operativ-Hetimor, në varësi të shefit të Departamentit Operativ-Hetimor krijohet njësia e kontrollit pas zhdoganimit (Posteriori).

b) Numri i përgjithshëm i punonjësve të njësisë së kontrollit pas zhdoganimit (Posteriori) të jetë 10 (dhjetë) vetë.

c) Numri i komandantëve të grupit të Drejtorisë së Antikontrabandës nga "20 (njëzet) vetë" të bëhet "15 (pesëmbëdhjetë) vetë".

ç) Numri i doganierëve të antikontrabandës nga "80 (tetëdhjetë) vetë" të bëhet "75 (shtatëdhjetë e pesë) vetë".

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.503, datë 18.7.2003

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR VALIAS-QERREKË-RINAS, SI DHE
TË PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE NDODHEN BRENDA RRETHIMIT TË
AEROPORTIT “NËNË TEREZA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik“, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Valias-Qerrekë-Rinas, si dhe të pronarëve, pasuritë e të cilëve ndodhen brenda rrethimit të aeroportit “Nënë Tereza”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të “Albtransport”-sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqet 14 137 m² tokë/arë, 10 600 m² tokë/truall dhe 14 774 m² kullotë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 34 469 200 (tridhjetë e katër milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 258 600 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë.

5. Fondi prej 34 727 800 (tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind) lekësh të përballohet nga “Albtransport” sh.a.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.7.2003.

7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë 90 ditë nga shpallja e fituesit të tenderit.

8. Mënyra e pagesës për çështjet në konflikt ose në proces regjistrimi të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

9. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Republika e Shqipërisë

Qarku Durrës

Fshati:Qërrek-Rinas

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
RRUGËS VALIAS-QERREK-RINAS, SI DHE PRONARËVE QË NDODHEN BRENDË
RRETHIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA”**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore, truall, kullotë nr.1-40

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr/pasurisë	Tokë bujqësore m ²	Truall sip m ²	Kullotë sip m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera (lekë)	Shënime
1	Avdulla		Kulla	146/13	100			1000	100000	Konfirmim Z.Rr.P.P
2	Sherif		Kallari	146/34	700			1000	700000	Konfirmim Z.Rr.P.P
3	Besim		Kallari	146/32	460			1000	460000	Konfirmim Z.Rr.P.P
4	Qamil	Lule	Kallari	146/30	403			1000	403000	Konfirmim Z.Rr.P.P
5	Mehdi	Kallari		146/28	288			1000	288000	Konfirmim Z.Rr.P.P
6	Ramazan		Kallari	146/28	300			1000	300000	Konfirmim Z.Rr.P.P
7	Shkëlqim		Kallari	146/24	113			1000	113000	Konfirmim Z.Rr.P.P
8	Beram		Kallari	146/22	213			1000	213000	Konfirmim Z.Rr.P.P
9	Esat		Kallari	146/20	288			1000	288000	Konfirmim Z.Rr.P.P
10	Petrit		Kallari	146/18	125			1000	125000	Konfirmim Z.Rr.P.P
11	Hysen		Kallari	146/16	350			1000	350000	Konfirmim Z.Rr.P.P
12	Kujtim		Kallari	140/21	495			1000	495000	Konfirmim Z.Rr.P.P
13	Petrit		Kallari	140/19	190			1000	190000	Konfirmim Z.Rr.P.P
14	Ramazan		Halili	140/17	520			1000	520000	Konfirmim Z.Rr.P.P
15	Xhemal		Sula	140/15	357			1000	357000	Konfirmim

										Z.Rr.P.P
16	Haxhi		Sula	140/13	674			1000	674000	Konfirmim Z.Rr.P.P
17	Fiqiri		Sula	140/11	925			1000	925000	Konfirmim Z.Rr.P.P
18	Xhelal		Sula	59/27	645			1000	645000	Konfirmim Z.Rr.P.P
19	Petrit		Sula	59/29	555			1000	555000	Konfirmim Z.Rr.P.P
20	Ram		Doku	59/31	100			1000	100000	Konfirmim Z.Rr.P.P
21	Naim		Doku	59/33	432			1000	432000	Konfirmim Z.Rr.P.P
22	Bedri		Maloku	59/34	390			1000	390000	Konfirmim Z.Rr.P.P
23	Mersin		Kurti	59/39	323			1000	323000	Konfirmim Z.Rr.P.P
24	Skënder		Cekeli	59/41	133			1000	133000	Konfirmim Z.Rr.P.P
25	Musa		Zhllima	59/43	405			1000	405000	Konfirmim Z.Rr.P.P
26	Etem		Zhllima	59/43	338			1000	338000	Konfirmim Z.Rr.P.P
27	Xhavit		Kallari	59/47	100			1000	100000	Konfirmim Z.Rr.P.P
28	Ramazan		Balliu	59/49	300			1000	300000	Konfirmim Z.Rr.P.P
29	Hider		Balliu	59/51	440			1000	440000	Konfirmim Z.Rr.P.P
30	Hamid		Balliu	59/53-10	1100			1000	1100000	Konfirmim Z.Rr.P.P
31	Sami		Doku	59/35	375			1000	375000	Konfirmim Z.Rr.P.P
32	Avdulla	Zenel	Kulla	147/9			1045	300	313500	
33	Avdulla	Zenel	Kulla	146/13			700	300	210000	Konfirmim Z.Rr.P.P
34	Avdulla	Zenel	Kulla	151/3			5561	300	1668300	
35	Zenel	Berush	Kulla	149		1200		1500	1800000	
36	Ali	Xhemal	Kurti	34/3	2000			1000	2000000	
37	Avdulla	Zenel	Kulla	148/2		4400		1500	6600000	
38	Halil		Lila	148/1		5000		1500	7500000	
39	Halil		Lila	217/1			5568	300	1670400	
40	Halil		Lila	150/7			1900	300	570000	
Shuma:					14137	10600	14774		34469200	

Mbyllet me numër rendor 40 (dyzet).

V E N D I M
Nr.506, datë 18.7.2003

**PËR NDËRTIMIN ME KONCESION TË AUTOSTRADËS RROGOZHINË-PEZË-DEGËZIM
TIRANË-VORË-THUMANË DHE ÇAKTIMIN E ORGANIT SHTETËROR TË
AUTORIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 pika 20 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të pakërkuar, paraqitur nga shoqëria “RIVIERA J.V.Ltd & sh.a. “DNS” S.A.” me “Ofertë publike” për ndërtimin me koncesion të autostradës Rrogzhinë -Pezë-Degëzim Tiranë-Vorë-Thumanë.

2. Caktimin e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit si Organ Shtetëror të Autorizuar për përgatitjen, negociimin, formulimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” me shoqërinë koncesionare “RIVIERA J.V.Ltd & sh.a. “DNS” S.A.”.

3. Kontrata e koncesionit të hyjë në fuqi pas ratifikimit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.507, datë 18.7.2003

**PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET QË I SHKAKTOHEN
PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE
TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 63 pika 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit kur transferohet, komandohet ose emërohet për herë të parë, për nevoja pune e shërbimi, në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe në komisaritet e policisë jashtë vendbanimit të vet, përfiton shpërblim mujor deri në ndryshimin e vendbanimit, në masën si më poshtë vijon:

a) Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës dhe në komisaritet e policisë së Kukësit, Tropojës, Hasit dhe Pukës, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

b) Në drejtoritë e policisë së qarqeve Shkodër e Dibër dhe në komisaritet e policisë së Shkodrës, Dibrës, Bulqizës, Matit, Malësisë së Madhe dhe Mirditës, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

c) Në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe në komisaritet e tjera të policisë, në masën 5 000 (pesëmijë) lekë.

2. Punonjësit të policisë, që transferohen për nevoja pune, në rastet e pamundësisë së punësimit të bashkëshortes/it, që më parë ka qenë në marrëdhënie pune, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 muaj deri në 1 vit;

b) 100 për qind të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 vit deri në 10 vjet;

c) 100 për qind të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indekskohet me rritjen e pagave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të policisë deri në 15 vjet, në rastet kur në vendbanimin përkatës nuk ekzistojnë mundësi punësimi, llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme

të punës për efekt pensioni. Kontributi i sigurimeve derdhet nga institucioni dhe përfituesi, sipas skemës së sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë.

Për përfitimin e kësaj pagese bashkëshortja/i duhet të bëjë kërkesë për t'u punësuar dhe të regjistrohet në zyrat e punësimit e të përkrahjes sociale dhe në institucionin ku punon bashkëshorti.

3. Punonjësit të Policisë së Shtetit, për punë cilësore, angazhim e rezultate të larta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit, gatishmërisë, ruajtjes së administrimit të pronës dhe në kryerjen e detyrave e të shërbimeve të veçanta, i jepet shpërblim deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit. Masa e shpërblimit përcaktohet dhe jepet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, deri në 2 (dy) paga mujore në vit dhe me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

5. Vendimi nr.86, datë 12.3.1992 i Këshillit të Ministrave “Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

6. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.508, datë 18.7.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRIË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, këtej e tutje të quajtura “Palë Kontraktuese”:

të udhëhequra nga dëshira për të zhvilluar dhe shtrirë bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ndërmjet vendeve të tyre;

të bindura që ky bashkëpunim do të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës së vendeve të tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe promovojnë bashkëpunimin në fushën e kujdesit shëndetësor mbi bazën e reciprocitetit dhe interesit të përbashkët dhe në përputhje me legjislacionin, që vepron në të dy vendet.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë kryesisht në fushat e mëposhtme prioritare:

1. Politika shëndetësore;
2. Dhënia e ndihmës mjekësore popullatës;
3. Kontrolli sanitar mbi ushqimet, mallrat dhe faktorët mjedisorë;
4. Kontrolli epidemiologjik i sëmundjeve infektive dhe parazitare;
5. Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve;
6. Politika e barnave mjekësore;
7. Legjislacioni shëndetësor;
8. Politika e trajnimit të stafit mjekësor;
9. Shkencat mjekësore.

Bashkëpunimi në fushat e përmendura nuk do të përjashtojë fusha të tjera për bashkëpunim sipas interesit të përbashkët.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin nëpërmjet:

1. shkëmbimit të informacionit mbi gjendjen shëndetësore të popullatës dhe kërkimeve në këtë fushë, të të dhënave statistikore në fushën e shëndetësisë, në aktet e legjislacionit shëndetësor etj.;
2. Shkëmbimit reciprok të ekspertëve dhe grupeve të studimit;
3. Pjesëmarrjes në takime ndërkombëtare që mbahen në vendin e Palës tjetër Kontraktuese;
4. kontakteve direkte ndërmjet institucioneve shëndetësore të të dyja Palëve Kontraktuese;
5. shkëmbimit të eksperiencës dhe rezultateve praktike për problemet prioritare të të dy vendeve.
6. shkëmbimit të informacionit mbi lejet për përdorimin e produkteve mjekësore, kontrollin e prodhimit të barnave mjekësore, përdorimin dhe shpërndarjen e barnave mjekësore;
7. formave të tjera bashkëpunimi siç do të bien dakord nga të dyja Palët Kontraktuese.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe promovojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ndërmjet universiteteve mjekësore, qendrave kombëtare mjekësore, spitaleve dhe institucioneve të tjera shëndetësore. Institucionet përkatëse mund të konkludojnë marrëveshje direkte, duke përcaktuar subjektet e bashkëpunimit, format, etapat dhe kushtet financiare.

Neni 5

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë pjesëmarrjen e specialistëve të tyre në kongrese shkencore kombëtare dhe aktivitete të tjera në fushën e shëndetësisë me pjesëmarrje ndërkombëtare. Për këtë qëllim ato do të shkëmbejnë informacion çdo vit për aktivitetet mjekësore të organizuara prej tyre, duke përfshirë kohën dhe vendin ku do të mbahen.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për sëmundjet ngjitëse të regjistruaram të cilat mund të shkaktojnë përhapje epidemish jashtë kufijve.
2. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion për gjendjen ekologjike të ambientit në

vendet e tyre dhe konform kompetencave të tyre do të koordinojnë përpjekjet për përmirësimin e tij, veçanërisht për çështjet që kanë të bëjnë me ndotjen.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë eksperiencë në përpunimin e programeve për trajnimin e stafit mjekësor dhe kualifikimeve pasuniversitare, do të ftojnë trajnues për të dhënë leksione si ekspertë për të zhvilluar projekte.

Neni 8

Dhënia e ndihmës mjekësore dhe trajtimi i qytetarëve të të dy vendeve gjatë qëndrimit në vendin tjetër do të kryhet në përputhje me legjislacionin që vepron në vendin pritës.

Neni 9

1. Palët Kontraktuese do të caktojnë Ministrinë e Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë të Republikës së Bullgarisë si organet kompetente për koordinimin e aktiviteteve të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Përfaqësues të Ministrisë të Shëndetësisë së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë të Bullgarisë, çdo vit, do të sigurojnë me radhë mbledhje për vlerësimin e realizimit të Marrëveshjes dhe për të përcaktuar aktivitete të reja specifike për vitin përkatës.

3. Shpenzimet për akomodimin (hotel dhe ushqim) për pjesëmarrësit sipas paragrafit 2 do të mbulohen nga Pala pritëse dhe shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga Pala dërguese.

Neni 10

Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë mjekë, dentistë, farmacistë, kërkues, lektorë dhe specialistë të tjerë mjekësorë për trajnime profesionale afatshkurtëra ose shkëmbim eksperience. Palët bien dakord që shkëmbimi i specialistëve do të organizohet sipas kushteve financiare të mëposhtme:

1. Jo mbi bazë valute, për jo më shumë se 30 ditë në vit, që do të realizohet reciprokisht. Në këtë rast, Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit ndërmjet dy kryeqyteteve. Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e hotelit, dietat ditore dhe transportin brenda vendit. Shuma e kuotës financiare ditore do të vendoset konform legjislacionit në vendin e Palës pritëse.

2. Mbi baza valute, kur Pala dërguese do të paguajë shpenzimet për dietat ditore, hotelin dhe udhëtimin.

3. Të dyja Palët do të informojnë njëra-tjetrën për datën e programuar të vizitës, numrin e ekspertëve, pozicionet përkatëse, aftësinë në gjuhën e huaj të folur dhe temat për të cilat do të diskutohet, të paktën dy muaj para datës së planifikuar të vizitës.

Neni 11

Në rastet kur ftohen specialistë për të marrë pjesë në kongrese mjekësore dhe takime të tjera, kushtet financiare do të deklarohen në ftesë.

Neni 12

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së notës së dytë diplomatike, me anë të së cilës, Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të të dy vendeve, për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

2. Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Vlefshmëria e saj do të rinovohet automatikisht për çdo periudhë pasardhëse 5 (pesë) vjeçare, nëse asnjë prej Palëve Kontraktuese nuk e përfundon atë, duke njoftuar Palën tjetër në formë të shkruar, mbi qëllimin e saj për ta përfunduar atë, të paktën 6 (gjashtë) muaj para skadimit të periudhës respektive të aktivizimit të Marrëveshjes.

Neni 13

Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, e nënshkruar në Sofie më 13 mars 1990, do të deklarohet e pavlefshme në marrëdhëniet ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 5 qershor 2003 në dy kopje origjinale, në shqip, bullgarisht dhe anglisht, secili nga tekstet do të jetë njësoj i barasvlefshëm. Në rast interpretimesh të ndryshme, teksti në anglisht do të ketë fuqinë dominuese.

V E N D I M **Nr.516, datë 18.7.2003**

PËR KALIMIN E VARËSISË SË TIPOGRAFISË USHTARAKE SHA NGA MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tipografia ushtarake sh.a., me mjetet kryesore dhe objektet e saj, e cila deri më tani ka qenë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojë në varësi Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimim e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM **Nr.4, datë 18.7.2003**

PËR KËRKESAT E DOKUMENTACIONIT LIGJOR DHE TEKNIK, QË DUHET TË PËRMBAJË DOSJA E DIGAVE DHE E DAMBAVE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 9 shkronja “b” dhe 13 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

A. Dokumentacioni ligjor që duhet të përmbajë dosja e digave dhe e dambave të reja dhe ekzistuese për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre, të jetë si më poshtë vijon:

1. Licencën e kategorive përkatëse për projektim dhe zbatim, lëshuar nga Ministria e

Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit.

2. Licencën e shfrytëzimit lëshuar nga institucionet përkatëse.

3. Dokumentacionin ligjor të parashikuar në nenin 6 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”.

B. Dokumentacioni teknik që duhet të përmbajë dosja e digave dhe e dambave të reja dhe ekzistuese për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre, të jetë si më poshtë vijon:

I. Për digat/dambat që do të ndërtohen

Për të gjitha digat/dambat e reja, që do të ndërtohen, duhet dokumentacioni teknik i parashikuar në nenin 5 kreu III të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”.

II. Për digat dhe dambat ekzistuese në shfrytëzim

Emri i digës _____

Emri i lumit/përroit _____

Të dhëna të përgjithshme:

1. Emri i ministrisë ose i institucionit investues që paraqet dosjen.

2. Shfrytëzimi i veprës (pronari ose koncesionari).

3. Përgjegjësi i punimeve (ndërmarrja që e ka ndërtuar).

4. Projektuesi.

5. Mbikëqyrësi i punimeve.

6. Organizata e studimeve kryesore.

7. Organizata e studimeve të veçanta: (gjeologji, gjeofizikë, mekanikë shkëmbi, mekanikë dherash, modelim, hidrologji etj.).

8. Rrjedhja e ujit (mënyra e mbushjes: me burimin e vet, me kanal ushqyes, me stacion pompimi etj.).

9. Qarku.

10. Bashkia më e afërt.

11. Destinacioni kryesor dhe ndihmës i digës.

Karakteristikat kryesore të digës ekzistuese

1. Natyra (muraturë e zakonshme, beton, beton arme, mbushje me gurë, mbushje dheu, e përzierë dhe me gurë etj.).

2. Tipi (me rëndesë, hark-rëndesë, hark, me shumë harqe, kundërforcë, digë dheu, digë guri, digë dheu dhe guri me bërthamë argjile ose me ekran prej argjile, betoni, bitumi, gjeomembranë etj.).

3. Formacioni i bazamentit.

4. Lartësia mbi terrenin natyror dhe nga pika më e ulët e gërmimit.

5. Gjatësia e kurorës.

6. Gjerësia maksimale në nivelin e terrenit natyror (bazamentit).

7. Pjerrësia e skarpatës së sipërme.

8. Pjerrësia e skarpatës së poshtme;

9. Rrezja e kurbaturës në anën e sipërme të kurorës.

10. Lartësia e kurorës së digës (Vm).

11. Lartësia e kurorës së pragut të shkarkuesit (Vm).

12. Vëllimi i trupit të digës.

13. Dispozitivat e vrojtimit (matja e prurjeve të filtrimit, prurja e drenave, piezometrat, pendulet, instalimet për vizime topografike, dispozitivat e matjes së uljeve ose të deformacioneve, ekstensiometrat, etj.).

14. Periudha e kryerjes së punimeve të ndërtimit të digës nga _____ deri në _____.

15. Data e vënies për herë të parë në ngarkesë.

16. Data e zbrazjes së fundit.

17. Data dhe natyra e incidenteve të vëna re pas vënies së parë nën ngarkesë, data dhe natyra e riparimeve kryesore të kryera mbi digë dhe në organet anekse të saj.

Karakteristikat kryesore të rezervuarit

1. Lartësia e nivelit maksimal për shfrytëzim normal VNN (ml).

2. Lartësia e nivelit maksimal të jashtëzakonshëm VNM (ml);

3. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit në nivelin normal (km²)’

4. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit në nivelin maksimal (km²);
5. Kapaciteti i përgjithshëm i rezervuarit (në 106 m³);
6. Kapaciteti i vëllimit të dobishëm (në 106 m³);
7. Kurbat $V=f(H)$; $S=f(H)$.
8. Koha e mbushjes së vëllimit të vdekur.

Karakteristikat klimatike dhe hidrologjike

1. Temperaturat ekstreme në vitin mesatar.
2. Sipërfaqja e basenit shimbledhës (në km²).
3. Lartësia e rreshjeve mesatare vjetore (në mm).
4. Prurja mesatare vjetore e lumit/përroit (në m³/sek) në aksin e digës.
5. Plotat historike të matura.
6. Data e plotës më të madhe të vrojtuar.
7. Prurja e plotës më të madhe të vrojtuar (m³/sek).
8. Veprat e shkarkimit të plotave:
 - 8.1 tipi (kapërderdhës i lirë, kapërderdhës anësor, porta sipërfaqësore, puse dhe galeri etj.);
 - 8.2 numri dhe përmasat kryesore;
 - 8.3 vendndodhja;
 - 8.4 prurja maksimale që mund të shkarkohet me nivelin maksimal të jashtëzakonshëm (në m³/sek) dhe kapaciteti shkarkues i çdo veprë shkarkimi i shprehur me kurbat $Q=f(H)$.
9. Veprat e marrjes:
 - 9.1 tipi;
 - 9.2 prurja maksimale (në m³/sek).
10. Veprat e zbrazjes:
 - 10.1 tipi;
 - 10.2 numri dhe përmasat kryesore;
 - 10.3 prurja maksimale (në m³/sek);
 - 10.4 koha e zbrazjes së rezervuarit (duke supozuar se prurjet që hyjnë në rezervuar janë zero).
11. Prurja e përgjithshme që mund të shkarkohet (në m³/sek).
12. Shpejtësia e erës (km/orë).
13. Planimetria në shkallë të përshtatshme e bashkëvendosjes së veprave, seksione tip të digës, vizatime me përmasa të shkarkuesve dhe veprave të marrjes.

Karakteristika të tjera të aksit të veprës ekzistuese dhe të objekteve anekse të saj

Rregullore të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digës dhe anekseve të saj

III. Për digat dhe dambat ekzistuese ku do të kryhen punime riparimesh, rikonstruksionesh ose studime të ndryshme

Riparimet ose punimet e përmirësimit të propozuar

1. Ministria ose institucioni investues.
2. Natyra e punimeve.
3. Përgjegjësi i punimeve.
4. Mbikëqyrësi i punimeve.
5. Projektuesi:
 - 5.1 organizata e studimeve kryesore;
 - 5.2 organizata e studimeve të veçanta (gjeologji, gjeofizikë, mekanikë shkëmbi, mekanika e dherave, modelime, hidrologjia, etj.).

Dokumentet e përgjithshme

1. Relacioni me shënime të përgjithshme për veprën, së bashku me planin e vendosjes dhe argumentimin teknik të punimeve që parashikohen të kryhen.
2. Topografia e luginës dhe e aksit të digës. Kurbat e vëllimeve dhe të sipërfaqeve në funksion të kuotave të nivelit të ujit në rezervuar.
3. Studimi gjeologjik sintezë, që saktëson në mënyrë të veçantë, karakteristikat e përgjithshme dhe sizmitetin në aksin e digës, me hartat dhe prerjet gjeologjike të rajonit të luginës dhe të aksit të digës, në një shkallë të përshtatshme, kërkimet vendore të kryera më parë, para dhe pas ndërtimit të

veprës, interpretimi dhe konkluzionet e nxjerra prej tyre për qëndrueshmërinë e bazamentit dhe të mbështetjeve të veprës, papërshkueshmëria e luginës dhe qëndrueshmëria e brigjeve.

4. Studimi hidrologjik sintezë, që saktëson veçanërisht regjimin e plotave dhe eventualisht madhësinë e prurjes së ngurtë. Krahasoni me kapacitetin aktual të digës.

5. Shënim për incidentet në digë që lidhen me sigurinë publike, të cilat saktësojnë gjendjen e vendbanimeve, të rrugëve të komunikacionit dhe veprave e objekteve të rëndësishme, që ndodhen në afërsi imediate dhe poshtë rezervuarit, si dhe prezencën eventuale të rezervuarëve të tjerë në të njëjtën rrjedhë ujore, poshtë ose sipër digës në studim.

6. Planin e alarmit, të evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave.

Dokumentet e veçanta që i përkasin veprës ekzistuese

1. Relacion përshkrues:

a) Përshkrimi dhe funksionimi i veprës. Historiku i ndërtimit të saj dhe riparimet e fundit të kryera në të.

b) Karakteristikat mekanike të bazamentit.

c) Materialet e përdorura për ndërtimin e veprës: prejardhjen, karakteristikat dhe vendosjen në vepër.

ç) Dispozitat e vrojtimit dhe të dëgjimit: përshkrimi, regjistrimi i matjeve të kryera, interpretimi i tyre.

d) Raporti i mbushjes së parë me ujë të rezervuarit.

dh) Procesverbalet e kontrolleve të kryera në digë.

2. Vizatimet e veprës:

a) Planimetria e vendosjes.

b) Planimetria e veprës dhe e objekteve ndihmëse.

c) Prerja konstruktive e digës dhe e objekteve ndihmëse.

Dokumentet e veçanta që i takojnë punimeve të propozuara

1. Relacione përshkruese, shpjeguese dhe justifikuese:

a) Përshkrimi dhe shpjegimi për domosdoshmërinë e riparimit (përmirësimit) të digës.

b) Trajtimi i bazamentit: injektimi dhe drenazhet.

c) Riparimi i shkarkuesve të plotave.

ç) Dispozitivat e vrojtimit dhe të dëgjimit të veprës, të bazamentit, të mbështetjeve etj., eventualisht të brigjeve të kupës.

d) Preventivi vlerësues, shuma.

dh) Grafiku i zhvillimit të punimeve.

2. Vizatimet e veprës

a) Vizatimet e punimeve dhe të pajisjeve të propozuara.

b) Vizatimet e trajtimit të bazamentit (injektime, drenazhe).

c) Vizatimet e riparimit të shkarkuesve të plotës.

ç) Vizatimet e dispozitivave të vrojtimit dhe të dëgjimit të veprës, bazamentit dhe mbështetjeve, eventualisht brigjeve të kupës së rezervuarit.

3. Karakteristikat mekanike të bazamentit:

Provat e kryera në terren dhe në laborator.

4. Materialet përbërëse të veprës:

a) Prejardhja, rezultatet e të dhënave dhe të studimeve të kavave, provat në shpërthim etj.

b) Karakteristikat petrografike, mekanike, hidrodinamike etj., rezultatet e provave të kryera.

c) Hedhja në vepër: provat e kompaktësimit, mjetet e përdorura etj.

ç) Përfundimet.

5. Shënime të llogaritjeve të veprës së propozuar:

a) Metoda llogaritëse e përdorur.

b) Hipotezat e bëra.

c) Rezultatet e llogaritjeve.

ç) Krahasoni me vepër analoge.

6. Provat më model:

a) Modeli i përdorur.

b) Rezultatet e marra.

- c) Krahاسimi me rezultatet e llogaritjeve.
 - 7.Hollësi të konceptimit dhe veçanti të kryerjes së punimeve:
 - a) Punime përgatitore sidomos devijim provizor.
 - b) Objekti kryesor.
 - c) Objektet anekse.
 - ç) Masat e sigurisë të parashikuara gjatë ndërtimit, plotat, qëndrueshmëria e seksioneve etj.
 - d) Programi i vënies në punë.
 - 8. Masat e sigurisë:
 - a) Pasojat e një prishjeje të mundshme të veprës mbi vendburimet, rrugët e komunikacionit dhe veprat e rëndësishme, të vendosura në afërsi imediate dhe larg digës.
 - d) Dispozitivat e alarmit dhe organizimi i mbikëqyrjes së digës dhe të zonës përreth.
 - c) Masat e urgjencës.
 - 9.Hollësitë e punimeve:
 - a) Mënyra e këshillimit të ndërmarrjeve ose të ndërmarrjes së caktuar për kryerjen e punimeve.
 - b) Programi dhe kalendari i kryerjes së punimeve.
 - c) Personi fizik i ngarkuar për drejtimin e punimeve, mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe kontrollin e punimeve, si dhe zëvendësuesi i tij.
 - Identiteti dhe titujt.
 - Referencat dhe përgjegjësitë.
 - Qëllimi, mundësitë dhe mjetet e kryerjes.
 - 10.Lista e studimeve të mëparshme për veprën:
 - a) Projekti dhe fituesi i kryerjes së punimeve.
 - b) Afati i paraqitjes së dosjes.
 - c) Numri i dosjes.
 - ç) Dërguesi i dosjes.
 - 11.Rregullore e shfrytëzimit dhe e mirëmbajtjes së digës dhe veprave anekse të saj, në rast se gjatë riparimit do të ketë ndryshime.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 31.7.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë